

URDHËR
Nr. 547, datë 10.5.2019

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 28, germa “d”, e ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në funksion të mbarëvajtjes së veprimtarisë administrative dhe zbatimit të detyrimeve të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës për informimin e institucioneve shtetërore dhe të subjekteve të tjerë që ushtrojnë funksione publike, mbi të dhënat kadastrale, të dhënat për ndërtimet në proces legalizimi, si dhe për inventarët e pronave të paluajtshme të shtetit dhe listës së pronave të transferuara te njësitë e qeverisjes vendore. Kjo kompetencë i delegohet drejtorit të njësisë së kadastrës dhe hartografisë, z. Andi Proko.

2. Kompetenca e deleguar sipas pikës 1, të këtij urdhri, të ushtrohet duke filluar nga data 13.5.2019, deri në shfuqizimin e tij.

3. Në rast mungese në detyrë të z. Andi Proko, delegimi i kompetencës konsiderohet i ndërprerë për periudhën e mungesës, në kuptim të nenit 29, pika 2, germa “ç”, të Kodit të Procedurave Administrative. Gjatë mungesës kompetenca ushtrohet nga drejtori i përgjithshëm i ASHK-së.

4. Ngarkohet z. Andi Proko, njësia e kadastrës dhe hartografisë, drejtoria e shërbimeve mbështetëse dhe sektori i arkivit dhe protokollit, në drejtorinë e përgjithshme të ASHK-së, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi në datën 13.5.2019 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Artan Lame